



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SKRAPAR**  
**KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR**

**VENDIM**

**Nr.31, datë 29. 06. 2021**

**“PËR DHËNIEN E DAKORDËSISË PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE TË HEQJES DHE DHËNIES NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR- KULLOSOR PUBLIK, TË SIPËRFAQEVE NË PRONËSI TË BASHKISË SKRAPAR, PËR NDËRTIMIN E HEC- eve, “BACKA 1; A; C”, NGA SHOQËRIA “KROI MBRET ENERGY” SH.P.K”.**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 29.06.2021, pasi mori në shqyrtim projektaktin e paraqitur nga Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor, hartuar në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin Nr.8480, date 27.05.1999, “Për Funksonimin e Organeve Kolegjiale të Administrates Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr.44/2015, “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligji Nr. 107/2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, Ligjin Nr. 9385/2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, i ndryshuar, Ligjin Nr.10304/2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, VKM- në Nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave Publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish Komunave/ Bashkive”, VKM-në Nr. 591, datë 09.10.2018 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1353, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor”, VKM-në Nr. 592, datë 09.10.2018, “Për disa ndryshime në vendimin Nr. 1374, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”, Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr. 1, datë 09.06.206, “Për rregullat ,procedurat e kërimit, të shfrytëzimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor kullor publik”

**VENDOSI :**

1. “Të shprehë dakordësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondit pyjor-kullor të sipërfaqes prej 0.1643 ha, në ngastrat 78; 93 a, në ekonominë pyjore, Turbohovë- Potom, si dhe në ngastrat 11; 13; 15; 19; 22 në ekonominë kullorë Backë, që do të përdoren nga shoqëria “Kroi Mbret Energy” sh.p.k”, për veprat e marrjes (baseni presionit, dekantues dhe godinat).
2. “Të shprehë dakordësinë për vijimin e procedurave të dhënies në përdorim të fondit pyjor- kullor të sipërfaqes prej 1.6122 ha, në një gjatësi prej 7.617 km, në ngastrat 72; 78; 91c; 92b, në ekonominë pyjore, Turbohovë- Potom, si dhe në ngastrat 11; 12; 13; 15; 18; 19; 22 në ekonominë kullorë Backë, që do të përdoren nga



shoqëria “Kroi Mbret Energy” sh.p.k”. ( për shtrirjen e tubacioneve, kanaleve deviacionit).

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor, Bashkia Skrapar.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”.

Vendimi u miratua me 9 vota pro, vota kundër – s’ka, vota abstenim- s’ka.

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

**KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK**

**Edlira SHKËMBI**

